

KËRKESË

KËRKUES: Valbona Balliu, e bija e Lutfiut dhe e Bukuries e datëlindjes 23.05.1968, lindur dhe banuese në Gramsh, me arsim të mesëm, e martuar me dy fëmijë.

OBJEKTI: Kërkohet shpallja si të zhdukur që nga viti 1995 të bashkëshortit tim Tahir Qemal Balliu.

BAZA LIGJORE: Neni 15 e vijues i K, civil dhe nenit 375 të K. Pr. Civile.

PËRPARA

GJYKATËS SË RRETHIT

GRAMSH

Zoti Kryetar !

Unë kërkuesja Valbona Lutfi Balliu, jam martuar me Tahir Qemal Balliu me 5 Nëntor 1989. Gjatë jetës sonë bashkëshortore kemi kaluar mirë pa asnjë problem. Kemi lindur dy fëmijë, Silvini të datëlindjes 19.07.1990 dhe Lindion të datëlindjes 1993.

Për arsye ekonomike bashkëshorti im Tahir Qemal Balliu është larguar më 13.01.1995.

Që nga dita e largimit dhe deri më sot nuk kam marrë asnjë informacion për vendndodhjen e tij, dhe nëse është apo s'është gjallë.

Kam bërë të gjitha përpjekjet duke pyetur me gjithçka ka qenë e mundur për të marrë ndonjë informacion, por deri tani nuk kam marrë asgjë.

Në vështrim të nenit 15 të K. Civil të Republikës së Shqipërisë personi që mungon nga vendbanimi i tij dhe për të cilin nuk ka lajme për vendndodhjen e tij me gjithë interesimet e bëra në organet shtetërore të vendit tonë dhe jashtë shtetit në Greqi, nuk kemi marrë asnjë lajm se ku ndodhet dhe nëse është gjallë ose jo, si dhe meqenëse ka afro pesë vjet nga koha e largimit, kërkohet shpalljen e tij si të zhdukur nga viti 1995.

Për këtë, kërkohet, nga ana e gjykatës që të pranohet kërkesa me qëllim që të vazhdojë procedura e mëtejshme sipas ligjit.

KËRKUESJA
Valbona Balliu